

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me sekretaren juridike Azize Rama, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit Sh. S. (A.) të cilin me autorizim e përfaqson babai i tij A.S. nga fsh. P..., K.Vitisë ,kundër të paditurit Xh. Xh.(M.), nga fsh.P... K.Vitia tani me adres të pa njohur, të colin e perfaqson av. H.S.. nga Vitia, me bazë të kontestit vërtetim i pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 29.06.2017, shpallë këtë;

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit Sh. S. nga fsh.P...,K.Vitisë dhe **i njihet** e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale nr.xxxx, në sipërfaqe prej xxxxm2 , në vendin e quajtur “S. P”, e evidentuar në Certifikatën e pronës xxxx, ZK.P..., të regjistruara në emër të pronarit juridik Xh. Xh. (M) nga P..., **në bazë të shitblerjes**.

DETYROHET i padituri Xh. Xh.(M.),nga P...tani me adrese te panjohur, t’ia njohë të drejtën e pronësisë paditësit S... S. (A.),nga P... K.Viti,dhe të durojnë që ngastren e lartpërmendur të regjistrojnë në emrin e paditësit.

Ky aktgjykim për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Vitisë, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

II.Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

A r s y e t i m

Gjykata të paditurës Xh. Xh. (M.), nga P... , i kishte dërguar përgjigje në padi, por përgjigjja nuk ishte kthyer, sepse i padituri ishte i pamundur t’i gjindet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, ne fletëkethese thuhej se i padituri ishte i panjohur.

Ne seancen e dates xxxxx,përfaqsesi i paditësi Sh.. S.. (A.), A. S.. deklaron: Mbetem në tërsi pranë padis dhe kërkes padis dhe kërkoj nga gjykata që ti njihet e drejta e pronsisë në ngastren kadastrale nr.xxxxx ne vendin e quajtur “S. S.P.”, babai i paditësit kete ngaster e kishte bler diku ne vitin xxxx një ari e ka paguar nga xxxx DM, dhe qe nga ajo kohë ka hyr ne posedim dhe shfrytezim pa u penguar nga askush.

Përfaqsesi i paditesit Sh. S dhe A.S. i ka propozuar Gjykatës qe të paditurit ti caktohet një përfaqësues i përkohshem, ku gjykata kishte vendosur duke caktuar përfaqësuesin e përkohshem për të paditurin av. H. S. nga Vitia.

Përfaqesusi i paditësit Sh. S. , A. S. në seancën e dt.xxxxx, i ka propozuar gjykatës që gjykata të caktoj një ekspert të gjeodezisë me qëllim të identifikimit të ngastres kadastrale nr.xxxx, ZK.P.....

Gjykata ka aprovuar propozimin e paditësit dhe së bashku me ekspertin e gjeodezisë ka dalur në vendin e ngjarjes me dt.xxxxx, ka bërë identifikimin e ngastres kadastrale nr.xxxx. Ngastra nr. xxxx ZK.P...n në vendin e quajtur "S S P", e cila ngaster për nga gjatësia shtrihet lindje-perendim, ndërsa për nga gjerësia veri-jug, e cila me kulturë është oborr.

Perfaqesusi i paditesit Sh. S., A.S. i ka propozuar Gjykatës që për seancën e radhës të ndëgjohen dy dëshmitare që kanë njohuri lidhur me shitblerjen e kësaj ngastre. Gjykata kishte aprovuar propozimin e paditësit për ndëgjimin e dy dëshmitarve që kishin njohuri mbishitblerjen e kësaj ngastre.

Dëshmitari F. S. nga fshati P... ka deklaruar: Këtë ngaster për të cilën bëhet fjalë e ka blerë babai i paditësit A. S., nga i padituri Gj. Gj., diku para Luftës për afersisht vitin nuk mu kujtohet por e di se në fsh.P... kanë ardhur nga fsh.B... , diku rrethë vitit xxx. Unë nuk kam qenë prezent kur është bërë kjo shitblerje por kam ndëgjuar nga njerzit se këtë ngaster e kishte blerë A. i B...nga se në të kishim një ngaster-are në mëshë me ta. Nga koha kur është blerë kjo ngaster këta kanë hyrë në posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush, dhe unë nuk kam ndëgjuar që të jetë ankuar diku nga serbet që mos të kenë marrë qmimin e kontraktuar.

Dëshmitari N. B. nga fshati R..., ka deklaruar: E di se për të cilën ngaster bëhet fjalë për ngastren e A.. S..në fsh.P.... , të cilën ngaster e ka blerë nga një qytetar i nacionalitetit serb i quajtur Gj. Gj. ngastra është blerë diku para luftës , kur pas blerjes kanë hyrë në posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush.

Shitblerja e kësaj ngastre është bërë me marka Gjermane , unë kam qenë prezent kur është bërë kjo marrëveshje mirpo kam qenë i ri , dhe prezent ka qenë edhe babai im , i cili tashtë nuk është në jetë. Unë nuk kam ndëgjuar që të jetë ankuar ndonjë qytetar i nacionalitetit serb për këtë ngaster.

Në procedurën e provave gjykata ka: Lexuar Certifikatën e pronës, nr.xxxx, e dt.xxxx, në emër të Gj. Gj. (Mj), kopja e planit me nr.xxxx në emër të Gjx Gjx (Mxx). Përgjegjeja e AKP, nr.REF-xxxx/MB e dt.xxxx. Përgjegjeja e policisë në Pozheran, e dt.xxxx. Ekspertiza e dt.xxxx, e përpiluar nga eksperti gjeodezisë.

Përfaqesusi i paditësit A. S.. në fjalën perfundimtare ka deklaruar: Mbetem në tersi pranë padisë dhe kerkespadiisë dhe kërkoj nga gjykata që të më njihet e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale xxxx në vendin e quajtur "S. S. P.", në sipërfaqe prej xxxx m², ZK.P...., nga se ky faktë është argumentua mirë me daljen e gjykatës në vendin e ngjarjes së bashku me ekspert të gjeodezisë ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë si dhe ndëgjimi i dy dëshmitarve në këtë shqyrtim gjyqësor F.. S.. nga fsh.P.. dhe N.. B... nga fsh.R...

Andaj kërkoj nga gjykata që gjykata ta aprovon padinë dhe kerkes padinë dhe të më njihet e drejten e pronësisë në ngastren e lartë përmendur.

Përfaqesuesi i perkoshem i të paditurit G. G.. (M.)av.H. S. në fjalën perfundimtare të palve deklaroi me rastin e daljes se gjykatës së bashku me ekspertin e gjeometrinë në vendin e ngjarjes është

konstatuar se paditësi e ka rrethuar ngastren kontestuse duke e bashkangjitur te njejten me palujtshmerin e tij ne të njejtin vend.

Dëshmitaret e ndegjuar deklarajn se babai i paditesit Sh. S. e kabler ngastren kontestuse nga shitësi tani i padituri dhe se i njejti ndaj te paditurit i ka kryer te gjithan obligimet e tija shitblerjes andaj i propozoj gjykates qe lidhur me këtë kontest te vendos ne baze te provave te provave te administruar.

Gjykata analizoi thënjet e palëve ndergjygjse, provat e administruara dhe konstatoj: se ngastra katastrale nr.xxxx, e evidentuar ne emër të të paditurit Gj. Gj. (M.),që vertetohet ne bazë të qertifikatës së prones me numër xxxx zona katastrale P...të cilen ngastër babai i paditësit e kishte blerë nga Gj. Gj. (M.). Babai i paditësit A. S. e ka paguar në tersi qmimin e shitblerjës të ngastres kadastrale, ka hyrë në posedim dhe shfrytzim pa u penguar nga askush ku kjo është vertetua nga deklaratat e dëshmitarve si dhe daljës së gjykatës në vendin e ngjarjës, së bashku me ekspert e gjeodezisë nga keto arsye gjykata i njehë të drejtën e pronsisë, paditësit Sh. S. nga fshati P...., si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN -DEGA NE VITI

C.nr. 288/2015

Me 29.06.2017

Sekretare Juridike:
Azize Rama

Gj y q t a r i
Nexhat Aliu

KESHILLA JURIDIKE:Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankese, ne afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes, ne Gjykatën e Apelit ne Prishtinë, përmes kesaj gjykate.